



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure




Instituti për Planifikim Hapësinor
Institut za Prostorno Planiranje
Institute of Spatial Planning

F T E S Ë

SHQYRTIM PUBLIK

Draft - Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar Sharri
Draft - Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Parkun Kombëtar Sharri



Burimi – PH i PK Sharri

Të nderuar qytetarë, pjesëtarë të komunitetit, ekspertë të mjedisit, përfaqësues të autoriteteve lokale dhe qendrore, biznese dhe palëve të interesuara - Kemi kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në Shqyrtimin Publik ku do prezantohen dhe diskutohet mbi **draft - Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri** si dhe **draft- Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)** për Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri. Ky aktivitet ofron një mundësi për të ndarë mendimet tuaja, për të parashtruar pyetje dhe për të kontribuar në formësimin e së ardhmes së kësaj zone të rëndësishme natyrore.

Hapja formale e shqyrtimit publik bëhet më 02.04.2025 (e mërkurë) me publikimin e ftesës për pjesëmarrje në Ueb faqen e Ministrisë.

Debatet nëpër komuna do të mbahen sipas orarit të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------|--|
| • Debati në Prizren | 08.04.2025 prej orës 10-12 - Premium Park Hotel; |
| • Debati në Suharekë | 15.04.2025 prej orës 10-12 - Hotel Solid; |
| • Debati në Dragash | 16.04.2025 prej orës 10-12 - Restaurant & Pizzeria "Palma"; |
| • Debati në Shtërpce | 17.04.2025 prej orës 10-12 - Hotel Brezovica; |
| • Debati në Kaçanik | 23.04.2025 prej orës 10-12 - Hotel Europa 92 |

AGJENDA E TAKIMEVE

09:30 – 10:00 Mirëseardhje & Kafe;

10:00 – 10:10 Fjalimet hyrëse;

10:10 – 10:40 Prezantim: draft-Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri”;

10:40 – 11:00 Prezantim: draft – Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për draft-Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”;

11:00 – 11:30 Debat i hapur;

11:30 – 12:00 Hapat e ardhshëm dhe mbyllja e debatit publik;

12:00 – 13:00 Dreka

Pse është e rëndësishme pjesëmarrja juaj:

Parku Kombëtar Sharri është një nga pasuritë më të rëndësishme natyrore në rajonin tonë, i njohur për biodiversitetin, trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë mjedisore. Ky plan synon të balancojë zhvillimin e qëndrueshëm me ruajtjen e këtij ekosistemi unik. Së bashku mund të punojmë për një të ardhme që harmonizon zhvillimin dhe ruajtjen e Parkut Kombëtar Sharri.

Kontributi juaj do të ndihmojë:

- Që plani hapësinor të reflektojë nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve lokale.
- Të identifikohen ndikimet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të zhvillimeve të propozuara.
- Të forcohen strategjitë për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të parkut.

Aktiviteti organizohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor, me mbështetjen e UN-Habitat Kosova/SwEPA dhe OSBE-së/Misioni në Kosovë.

Ju bëjmë me dije se dokumentet janë rezultat i punës së përbashkët të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, komunave, institucioneve relevante, profesionistëve të fushave të ndryshme si dhe pjesëmarrësve nga shoqëria civile.

Nga dita e hapjes formale të shqyrtimit publik, dokumentet mund ti gjeni dhe ti shkarkoni nga ueb-faqen <https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements>, të njëjtit mund ti merrni në CD në zyrat e Institutit për Planifikim Hapësinor, ndërtesa e “Ish Rilindjes” kati XIV në Prishtinë. Komentet mund t’i dërgoni deri më 03.05.2025, në adresën arben.rrecaj@rks-gov.net; rizah.murseli@rks-gov.net; dhe rizah.muqolli@rks-gov.net.

Ju mirëpresim.